



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14 MAR 2023

14-030/01-54576/23 më \_\_\_\_\_

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01, nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet qarkullimi i mjeteve motorike në Bulevardin "Zejnel Saliu", nga udhëkryqi i Rr. "Emin Duraku", deri te kryqëzimi me Rr. "Emest Koliqi".
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, lejohej qarkullimi i automjeteve të emergjencës, zjarrfikësve, të Policisë së Kosovës, automjetet të cilat shërbejnë për transportin e personave me nevoja të veçanta, dhe veturave me rëndësi të veçantë.
3. Përgjatë Bulevardit të "Zejnel Saliu", do të jete hapësire e veçantë për lëvizje të këmbësoreve e destinuar vetëm për lëvizje aktive, i njëjti do të jetë i sinjalizuar dhe i kompletuar me sinjalizim vertikal dhe horizontal të trafikut rrugor.
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Skica hartografike.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U D O R Ë Z O H E T:

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Operativës Regjionale të Policisë,  
Sektorit të Operativës Policisë - NJRKRR DRP;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

